



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4804/1 Prot.

Tiranë, më 26.7.2023

URDHËR

Nr. 414, datë 26.7.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 313, DATË 20.10.2020 TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE PROCEDURAT E EMËRIMIT, PEZULLIMIT DHE LARGIMIT NË SHËRBIMIN PSIKOSOCIAL", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 20 dhe të shkronjës "a" të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Në urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

a) Shkronja "a", e pikës 3, të Kreut III ndryshohet, si vijon:

*"a) "Psikologu duhet të ketë diplomë të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, ose ekuivalente me to në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015, dhe pas vitit 2019, licencë në fushën e psikologjisë së edukimit të lëshuar nga Urdhri i Psikologut".*

b) Pika 7, e Kreut IV, ndryshohet si vijon:

*"7. Për realizimin procedurave të konkurrimit dhe të shpalljes së listës të kandidatëve fitues, DRAP-i përkatës krijon një komision ad-hoc, i cili përbëhet nga 2 (dy) përfaqësues nga MAS-i, nga 1 (një) përfaqësues nga DPAP-ja, 1 (një) përfaqësues nga njëra prej ZVAP-ve, 1 (një) përfaqësues nga DRAP-i".*

c) Pas Kreut IV, shtohet Kreu IV/1, me përmbajtje:

**"KREU IV/1**

*1. Në përfundim të vitit shkollor procedurat e lëvizjes paralele administrohen nga DRAP-ja, për punonjësit e SHPS që ushtrojnë profesionin në institucionet arsimore*

publike parauniversitare, brenda juridiksionit të zyrave vendore të arsimit parauniversitar.

2. Punonjësi i SHPS që dëshiron të kryejë lëvizje paralele në përfundim të vitit shkollor, dërgon me postë në DRAP kërkesën për lëvizje paralele.
  3. Dorëzimi i dosjeve për lëvizje paralele bëhet sipas afateve të përcaktuara nga DPAP-ja.
  4. DRAP-ja krijon komisionin e vlerësimit të dosjeve për lëvizje paralele, me këtë përbërje:
    - a) drejtuesi i DRAP-së (kryetar);
    - b) një specialist i kurrikulës dhe zhvillimit profesional në DRAP (anëtar);
    - c) juristi i DRAP-së (anëtar).
  5. Komisioni i vlerësimit të dosjeve në DRAP bën vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për lëvizje paralele sipas shtojcës nr. 2 të urdhrit, sipas afateve të përcaktuara nga DPAP-ja.
  6. Komisioni i vlerësimit të dosjeve shpall renditjen e konkurrentëve për lëvizje paralele sipas zyrave vendore dhe pikëve në rendin zbritës. Lista me renditjen e punonjësve të SHPS shpallet në faqen elektronike zyrtare të DRAP-së, e cila dërgon një kopje të listës në DPAP.
  7. Punonjësi i renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës brenda ZVAP-së ku ka emërimin e përhershëm. Ai dërgon brenda 24 orëve me e-mail konfirmimin ose refuzimin e vendit të propozuar. Në rast të mos konfirmimit nga kandidati, ky vend pune i ofrohet punonjësit të listuar një rend më poshtë.
  8. Pas përzgjedhjes së vendit të punës nga kandidati, DRAP-i përkatës nxjerr aktin e emërimit të kandidatit në institucionin arsimor parauniversitar të përzgjedhur prej tij dhe nënshkruan kontratën e punës me të”.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**

**EVIS KUSHI**

